

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6178
E hënë, 30 nëntor 2020
çmimi 0.40

III. "Plagjiatura" e Dick Martyt dhe e vërteta për raportin që mban emrin e tij



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR ZGJEDHOR (KQZ) KA PUBLIKUAR REZULTATET PRELIMINARE PER ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE NË PODUJEVË DHE NE MITROVICË TE VERIUT

OPINION

TENDENCA PËR NGRITJEN E TERMOCENTRALEVE NGA GAZI, INTRIGË E RREZIKSHME E POLITIKËS QEVERITARE F. 11

Nga: Prof. Dr. Izet IBRAHIMI



SHPEJTIM BULLIQUI PËRMBYS BASTIONIN E LDK-së NË PODUJEVË



Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka fituar zgjedhjet në këtë qytet, duke e thyer bastionin e LDK-së që 20 vjet në udhëheqje të kësaj komune. Kandidati i LDK-së për kryetar komune, Nexhmi Rudari, ka fituar 35.97 për qind të votave. Ndërsa Millan Radojeviq nga Lista Serbe ka fituar 89.86 për qind të votave në Mitrovicë të Veriut

AKTUALE



KËRKOHEM MOBILIZIMI I INSTITUCIONEVE PËR T'I MBROJTUR ÇLIRIMTARËT NË HAGË F. 2

MALI I ZI DHE SERBIA DËBOJNË AMBASADORËT E NJËRI-TJETRIT F. 2

TË AKUZUARIT E GJYKATËS SPECIALE KANË NEVOJË PËR NDIHMËN E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS

KËRKOHEM MOBILIZIMI I INSTITUCIONEVE PËR T'I MBROJTUR ÇLIRIMTARËT NË HAGË

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë treguar se si mund t'i ndihmojnë institucionet e Kosovës ish-eporët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) që janë akuzuar nga Gjykata Speciale. Ata kanë thënë se Qeveria e Kosovës duhet të mobilizohet për t'u dalë në mbrojtje atyre. Sipas tyre, përveç ndihmës financiare,

institucionet duhet të ndihmojnë për gjetjen e provave që do ta ndihmojnë mbrojtjen e të akuzuarave. Njohësit e rrethanave politike kanë vlerësuar se me kërkesën e avokatëve, Qeveria e Kosovës mund të ndihmojë në zbardhjen e rrethanave të caktuara që do të mund t'i ndihmonin të akuzuarit në Hagë



MBI 1 000 TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË F. 6

SBASHK-U KUNDËR QEVERISË, SOT NUK KA MËSIM F. 6

EKONOMI

HUMBJE MILIARDËSHE, NDIHMË MILIONËSHE F. 9

REÇICA: ME PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE PO BËHET POLITIKË F. 8

SPORT

DRITA FITON ME PËRMBYSJE NDAJ GJILANIT F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DRENA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mali i Zi dhe Serbia dëbojnë ambasadorët e njëri-tjetrit

PODGORICË, 29 NËNTOR- Qeveria në shkuarje e Malit të Zi ka shpallur ambasadorin e Serbisë person të padëshiruar (non grata) dhe i ka kërkuar që të largohet nga shteti, ka njoftuar Ministria e Jashtme më 28 nëntor.

Serbia është përgjigjur disa orë më vonë duke e shpallur ambasadorin e Malit të Zi, po ashtu person të padëshiruar dhe duke e dëbuar nga shteti. Ministria e Jashtme e Malit të Zi ka cituar “ndërhijet e vazhdueshme në çështjet e brendshme të Malit të Zi” si arsye për marrje të këtij vendimi.

Në deklaratën e Ministrisë së Jashtme është thënë se ambasadori serb, Vladimir Bozhoviq “ka treguar jorespekt direkt” për Malin e Zi, duke e

përkthuar vendimin e vitit 1918 për t’iu bashkuar atëbotë Mbretërisë së dominuar nga Serbia si akt “të çlirimit” dhe “vullnetit të lirë” nga malazezët.

Parlamenti i Malit të Zi e ka shpallur këtë vendim si të pavlefshëm më 2018, duke thënë se i ka hequr Malit të Zi sovranitetin e vet.

Në deklaratë është thënë se komentet e Bozhoviqit më 27 nëntor kanë qenë “të papërshtatshme me standardet e zyrës diplomatike”.

Ministria e Jashtme e Serbisë ka njoftuar përgjigje reciproke.

“Për shkak të shpalljes së ambasadorit të Serbisë në Malin e Zi, Vladimir Bozhoviq, person të padëshiruar, Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë ka vepruar në mënyrë



reciproke”, është thënë në deklaratën e kësaj ministrie.

Mediet shtetërore ka raportuar se ambasadorit malazez Tarzan Millosheviq i është kërkuar të largohet nga Serbia brenda 72 orëve.

Mali i Zi vazhdon të jetë thellësisht i ndarë në mesin e

njerëzve që kërkojnë lidhje me aleatët tradicionalë, Serbinë dhe Rusinë, si dhe ata që e shohin Malin e Zi si shtet të pavarur, të lidhur me Perëndimin. Mali i Zi dhe Serbia kanë qenë pjesë e një shteti të përbashkët deri para mbajtjes së referendumit për

pavarësi më 2006, që ka rezultuar me ndarje të Malit të Zi nga Serbia.

Ky shtet tani do të drejtohet nga një koalicion pro-serb, që pritet të votohet gjatë seancës parlamentare javën ardhshme. Partia më e fuqishme e koalicionit është Fronti Demokratik.

Megjithatë, partnerët e saj insistojnë që Mali i Zi të vazhdojë rrugën pro-Perëndimore.

Ky ndryshim e ka lënë Partinë Demokratike të Socialistëve të drejtuar nga presidenti Millo Gjukanoviq jashtë pushtetit për herë të parë pas gati 30 vjetëve. Partia e tij, që është mposhtur në muajin gusht, ka udhëhequr shtetin drejt pavarësisë nga Serbia dhe drejt NATO-s më 2017.

Tre ministrat e jashtëm shqiptarë zotohen për projekte të përbashkëta



PRISHTINË, 29 NËNTOR- Tre ministrat e Jashtëm të rajonit, ministrja e Jashtme e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, ai i Shqipërisë, Gent Cakaj dhe ministri i Jashtëm shqiptar i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, u zotuan për rritje të bashkëpunimit me rastin e shënimit të 28 Nëntorit, ditës së shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Në njoftimin për

media, të dërguar nga zyra e Ministres së Jashtme të Kosovës, Haradinaj-Stublla thuhet se që të tre janë pajtuar që të punojnë në forcimin e rolit të të tria vendeve në rajon. “Në ditën e shënuar të festës kombëtare të shqiptarëve dhe 108-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ky takim virtual është simbol i forcimit të rolit të vendeve dhe

popullit tonë në rajon. U diskutua për thellim të marrëdhënieve dhe projekteve të përbashkëta midis të tre shteteve, si pararojë e vërtetë e integritit rajonal dhe fqinjësisë së mirë”, thuhet në njoftimin për medie. Të tre kryediplomatët thuhet se janë pajtuar që muajt në vijim të organizojnë një takim të përbashkët në Prishtinë.

Origjina e virusit, Kina tenton të ndryshojë historinë

PEKIN, 29 NËNTOR- Afro një vit pasi mjekët identifikuan rastet e para të një sëmundje të re shqetësuese në qytetin kinez të Wuhanit, vendi duket se ka ndërmarrë tani një fushatë për të vënë në pikëpyetje origjinën globale të pandemisë së koronavirusit.

Mediet shtetërore në Kinë kanë raportuar gjithnjë e më shumë për koronavirusin e zbuluar në paketimet e ushqimeve të ngrira të importuara, që nuk konsiderohet një faktor domethënës infektimi në vende të tjera dhe kërkimeve për raste të mundshme të sëmundjes së zbuluar jashtë kufijve të Kinës para dhjetorit 2019. Gazeta zyrtare e partisë së punës, pretendonte në një postim në “Facebook” se të gjitha provat në dispozicion sugjeronin se koronavirusi nuk

nisi në Wuhan. “Wuhani ishte vendi ku koronavirusi u konfirmua së pari, por jo vendi i origjinës së virusit”, citonte gazeta një ish-epidemiolog të qendrës kineze për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve.

Një zëdhënës i ministrisë së Jashtme të Kinës, i pyetur për raportet se virusi e kishte origjinën jashtë Kinës, tha vetëm se ishte e rëndësishme të bëhej dallimi mes vendit ku u pikas së pari Covid-19 dhe ku ai kaloi barrierat mes specieve për të infektuar njerëzit. “Edhe pse Kina ishte e para që raportoi rastet, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që virusi lindi në Kinë”, ka pohuar zëdhënësi në një konferencë për medie.

Ai ka theksuar se gjurmimi i origjinës është një proces në



vazhdim që mund të përfshijë shumë shtete dhe rajone. Shkencëtarët kinezë kanë ofruar madje edhe një studim

për publikim në revistën Lancet, që pretendon se Wuhani nuk është vendi ku transmetimi nga njeriu tek

njeriu i Sars Cov 2 ndodhi së pari, duke sugjeruar se rasti i parë mund të kish qenë në Indi.

KOMISIONI QENDROR ZGJEDHOR (KQZ) KA PUBLIKUAR REZULTATET PRELIMINARE PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE NË PODUJEVË DHE NË MITROVICË TË VERIUT

Shpejtim Bulliqi përmbys bastionin e LDK-së në Podujevë

Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka fituar zgjedhjet në këtë qytet, duke e thyer bastionin e LDK-së që 20 vjet në udhëheqje të kësaj komune. Kandidati i LDK-së për kryetar komune, Nexhmi Rudari, ka fituar 35.97 për qind të votave. Ndërsa Millan Radojeviq nga Lista Serbe ka fituar 89.86 për qind të votave në Mitrovicë të Veriut



votuesve, apo 35,400 persona. Në Mitrovicë të Veriut, ndërkaq, Erden Atiq nga Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 3.68 për qind të votave, Dushan Millunoviq, kandidat i pavarur, ka fituar 2.92 për qind dhe Florent Azemi nga Partia Demokratike e Kosovës ka fituar 3.54 për qind të votave. Në Mitrovicë të Veriut është thënë se kanë votuar 39.14 për qind e votuesve apo 9,124 persona. Mandati i kryetarëve të rinj do të jetë deri në zgjedhjet e ardhshme lokale që pritet të mbahen në tetor të vitit 2021. Podujeva mbeti pa kryetar pasi Agim Veliu u emërua Ministër i Punëve të Brendshme në qeverinë e udhëhequr nga ish-kryeministri Albin Kurti. Kurse Mitrovica e Veriut mbeti pa kryetar më datën 3 qershor, kur u votua Qeveria e re e Kosovës, e udhëhequr nga Avdullah Hoti.

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 NËNTOR- Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka njoftuar të dielën se në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Podujevë, sipas rezultateve preliminare, kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje, Shpejtim Bulliqi ka fituar 51.64 për qind të votave, ndërsa Millan Radojeviq nga Lista Serbe ka fituar 89.86 për qind të votave në

Mitrovicë të Veriut.

KQZ-ja ka bërë të ditur se në këto rezultate nuk përfshihen votat me kusht dhe ato nga diaspora. Dy kandidatët tjerë për pozitën e kryetarit në Podujevë, Nexhmi Rudari nga Lidhja Demokratike e Kosovës, ka fituar 35.97 për qind të votave, ndërsa Naim Fetahu nga Partia Demokratike e Kosovës ka fituar 12.40 për qind të votave.

Në Podujevë, të drejtën e votës e kanë shfrytëzuar 40.51 për qind e

IKD-ja: Qytetarët duhet të presin me vite për zgjidhjen e lëndëve civile

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin "Drejtësia Civile 2019". Ky raport është rezultat i monitorimit të drejtpërdrejtë të drejtësisë civile gjatë vitit 2019, ku përfshihen 1 715 seanca gjyqësore të monitoruara nga IKD. Përkundër garantimit të efikasitetit në letër, drejtësia civile vazhdon të jetë drejtësi e vonuar për qytetarët e Republikës së Kosovës. Gjetjet e monitorimit të IKD-së tregojnë se procedurat gjyqësore civile zvarriten në pothuajse secilën fazë procedurale, që nga caktimi i seancës përgatitore, përgjigjja në padi dhe shqyrtimi gjyqësor



progres, pasi numri i lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti vazhdimisht është ngritur. Nga viti 2016 e deri në vitin 2018 njëjtë ka ndodhur edhe në Gjykatën e Apelit, por se ky trend negativ është ndalur në vitin 2019, kur Gjykata e Apelit është përforcuar me gjyqtarë dhe numri i lëndëve të pazgjidhura që barten vit pas viti ka rënë, derisa ngarkesa me lëndë në Gjykatën Supreme përballon gjykimin e rasteve civile brenda një afati të arsyeshëm kohor. Sa i përket performancës së gjyqtarëve, IKD-ja gjen se, shprehur në mesatare, gjyqtarët e gjykatave themelore nuk kanë arritur të zgjidhin lëndë aq sa është e përcaktuar nga KGJK-ja me anë të normës orientuese, derisa këtë normë e kanë arritur gjyqtarët e Gjykatës së Apelit. Por, nëse trajtojmë performancën e gjyqtarëve veç e veç, IKD-ja gjen se ka një disbalancë të theksuar të numrit të lëndëve të zgjidhura në

mes të gjyqtarëve.

Por, përballë zvarritjeve të lëndëve civile dhe numrit të madh të lëndëve, IKD-ja ka gjetur se ka raste kur gjyqtarët kanë përfunduar rastet brenda afateve ligjore, përkundër faktit se me ligj të njëjtat raste nuk janë paraparë si lëndë me prioritet, duke treguar qasje selektive ndaj qytetarëve dhe trajtim të pabarabartë të palëve.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se në mesatare të rasteve të monitoruara dhe analizuara, kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile vetëm në shkallë të parë është 1 513 ditë, kurse për trajtimin e një rasti civil nga gjykata e shkallës së dytë, kur edhe konsiderohet se ka përfunduar lënda, është 1 288 ditë. Shprehur në total, i bie se për të përfunduar një rast nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në momentin kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë, mesatarisht duhet të kalojnë 2 801 ditë, apo

rreth 7 vjet e 8 muaj.

Kjo kohëzgjatje llogaritet të jetë nëse rasti vendoset në mënyrë meritore nga Gjykata e Apelit, e cila situatë gjatë vitit 2019 nuk është shprehur në 2 386 raste civile të trajtuara nga Gjykata e Apelit, të cilat raste janë kthyer nga kjo gjykata në rigjykim/rivendosje dhe rastet kanë filluar trajtimin përsëri nga fillimi. Numri i rasteve të kthyera në rigjykim që nga viti 2016 e deri në vitin 2019 është rritur vit pas viti. Por, shprehur në përqindje, në mes të numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të kthyera në rigjykim/rivendosje, kjo përqindje ka zbritur nga viti 2016 e deri në vitin 2018, derisa IKD gjen se kjo përqindje është ngritur përsëri në vitin 2019.

Sa iu përket rasteve karakteristike, IKD-ja gjen se në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës ka ende raste civile në të cilat padia është parashtruar në vitin 1997, por se e njëjta padi ende nuk ka marrë përgjigje definitive. Po ashtu, IKD-ja gjen raste kur lëndët civile janë zvarritur me dekada, për arsye se sistemi gjyqësor nuk ka arritur për vite të tëra që ta qartësojë situatën nëse një rast është apo jo "çështje e gjykuar". Për më tepër, IKD-ja në këtë raport ka evidentuar edhe trajtim diametralisht të ndryshëm nga ana e Gjykatës së Apelit të rasti të kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, i cili ishte trajtuar në procedurë përmbarimore dhe në procedurë penale nga kjo gjykatë.

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, ka publikuar raportin "Drejtësia Civile 2019". Ky raport është rezultat i monitorimit të drejtpërdrejtë të drejtësisë civile gjatë vitit 2019, ku përfshihen 1 715 seanca gjyqësore të monitoruara nga IKD.

Përkundër garantimit të efikasitetit në letër, drejtësia civile vazhdon të jetë drejtësi e vonuar për qytetarët e Republikës së Kosovës. Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës kanë garantuar efikasitet dhe cilësi të drejtësisë civile për të gjitha

kontestet juridiko-civile. Por, përballë kësaj, IKD-ja gjatë monitorimit sistematik të drejtësisë civile gjen se këto garanci kanë mbetur në letër dhe të pazbatuara në praktikë pasi gjetjet e monitorimit të IKD-së tregojnë se procedurat gjyqësore civile zvarriten në pothuajse secilën fazë procedurale, që nga caktimi i seancës përgatitore, përgjigjja në padi, shqyrtimi gjyqësor etj. Të gjitha këto shkelje në fund përbëjnë zvarritje të madhe të lëndëve civile, që në disa raste është edhe me dekada. Një ndër arsyet kryesore të kësaj zvarritje konsiderohet numri i madh i lëndëve civile me të cilat është i ngarkuar sistemi gjyqësor. Në kuptim të këtij fakti që pengon zhvillimin e gjyqësorisë brenda këtij afati të arsyeshëm, në drejtësinë civile në shkallë të parë që nga viti 2016 nuk ka pasur



TË AKUZUARIT E GJYKATËS SPECIALE KANË NEVOJË PËR NDIHMËN E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS

KËRKOHET MOBILIZIMI I INSTITUCIONEVE PËR T'I MBROJTUR ÇLIRIMTARËT NË HAGË

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë treguar se si mund t'i ndihmojnë institucionet e Kosovës ish-eporët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) që janë akuzuar nga Gjykata Speciale. Ata kanë thënë se Qeveria e Kosovës duhet të mobilizohet për t'u dalë në mbrojtje atyre. Sipas tyre, përveç ndihmës financiare, institucionet duhet të ndihmojnë për gjetjen e provave që do ta ndihmojnë mbrojtjen e të akuzuarave. Njohësit e rrethanave politike kanë vlerësuar se me kërkesën e avokatëve, Qeveria e Kosovës mund të ndihmojë në zbardhjen e rrethanave të caktuara që do të mund t'i ndihmonin të akuzuarit në Hagë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se institucionet e Kosovës duhet të mobilizohen për t'u dalë në ndihmë ish-eporëve të UÇK-së të cilët janë akuzuar për krime lufte nga Gjykata Speciale. Sipas tyre, institucionet duhet të ndihmojnë për gjetjen e provave që do ta ndihmojnë mbrojtjen e të akuzuarave. Ish-ministrja për Dialog, Edita

Tahiri, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se pas aktakuzave të para, Kosova gjendet në një situatë jo të mirë. "Kosova është në një gjendje shumë të rëndë në përgjithësi, në një rën anë për shkak të pandemisë dhe inicimi i proceseve nga Gjykata Speciale e ka rënduar këtë gjendje edhe më shumë. Kjo gjendje kërkon një mobilizim më të madh të institucioneve të shtetit tonë. E para për të siguruar një mbrojtje shtetërore sa më të mirë për ata që janë në gjykatë, në mënyrë që argumentimi të bëhet me

një mbështetje sa më të madhe institucionale", ka thënë Tahiri. Ajo ka vlerësuar se kjo situatë kërkon një unitet të spektrit politik. "Në këtë drejtim duhet të ketë një unitet politik dhe kombëtar. Në këtë kuadër kam bërë thirrje për një qeveri uniteti, që me të vërtetë do ta rriste kapacitetin institucional dhe nevojën për të folur me një gjuhë në këtë kohë të rëndë", është shprehur Tahiri. Profesori universitar Valon Murati beson se institucionet e Kosovës me kërkesë të avokatëve mund të ndihmojnë





zbardhjen e rrethanave të caktuara që do të mund t'i ndihmonin të akuzuarit. Përtej kësaj, do të jetë vështirë një ndërhyrje më e madhe sepse konsiderohet si ndërhyrje në drejtësi", ka deklaruar Murati për gazetën "Epoka e re", duke shtuar se lufta për të vërtetën e luftës çlirimtare duhet të jetë permanente. "Lufta për të vërtetën tonë e të luftës sonë pastaj është një çështje tjetër e të cilën duhet ta zhvillojmë çdo ditë e në mënyrë sistematike e jo me fushata të përkohshme dhe emocione të çastit", ka deklaruar Murati.

Ndërsa analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se ndihma materiale dhe juridike për të akuzuarit duhet të bëhet në mënyrë transparente. "Sa kam kuptuar, Qeveria e Kosovës është zotuar se do të ofrojë ndihmë materiale dhe juridike për të akuzuarit, dhe kjo është në rregull dhe duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe, çfarë është me rëndësi, profesionale për gjetjen e provave që do ta ndihmojnë mbrojtjen e të akuzuarave", ka vlerësuar Maliqi për gazetën "Epoka e re". Sipas tij, Kosova duhet të bëjë dekonstruktiv faktografik të propagandës serbe kundër luftës së UÇK-së. "Nuk do të duhej të bënim kundërpropagandë të thjeshtë, por dekonstruktiv faktografik të propagandës dhe sajësive paragjyqese serbe që luftën çlirimtare të UÇK-së e paraqesin si terrorizëm dhe luftë të motivuar me qëllime fetare. Për gjykatën, por edhe opinionin botëror, ne nuk kemi bërë sa duhet për rikujtimin e krimeve të planifikuara dhe masive të Serbisë dhe këto në dy aspekte, ato të faktuar me rreth 50 masakrat e popullsisë civile, ku shumica dërrmuese e tyre nuk janë hetuar dhe gjykuar, edhe nëse urdhëruesit dhe ekzekutorët nuk kanë marrë dënime meritore, por simbolike, në mos dhe janë

liruar nga përgjegjësia", ka thënë ai, duke shtuar se Kosova nuk ka ditur të mbajë gjallë dhe vazhdimisht të kërkojë dënimin e përgjegjësve të zvarrosjes të mijëra civilëve të vrarë në Kosovë që janë bartur në varrezat masive në Serbi. "Prej tyre janë hapur vetëm disa, më e madhe në Batajnicë, në poligonin e ushtrimit të forcave policore serbe, si një shembull më eklakant i përpjekjeve që të zhduken dëshmitë sipas logjikës së mbrapshtë dhe kriminele: 'Nëse nuk ka kufoma, nuk ka krim e as përgjegjësi'. Së fundi vetë qarqet kundër regjimit në Serbi kanë zbuluar se menjëherë pas përfundimit të luftës kabineti i kryeministrit Gjorgjiq ka qenë i informuar për Batajnicën dhe listën me gjithsejtë 16 varreza masive gjithandej Serbisë ku janë fshehur kufomat e viktimave civile shqiptare!", është shprehur Maliqi.

Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës do të bënte punë të madhe nëse do të bënte një promemorie ose padi ndaj Ivica Daçiqit dhe përgjegjësve të tjerë për krimet masive të luftës që kanë bërë forcat serbe e që kanë mbetur të pahetuara dhe të

pandëshkuara. "Në sfondin e kriminalizimit të luftës çlirimtare, zbardhja e këtyre krimeve do të riaktualizonte një kontekst tashmë të zbehur të motiveve pse ka qenë e pashmangshme kryengritja e UÇK-së dhe mobilizimi i tërë shoqërisë së Kosovës kundër regjimit serb dhe çlirimit të Kosovës", ka thënë Maliqi.

Ditë më parë edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka deklaruar se Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet për mbrojtjen e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët po akuzohen nga Gjykata Speciale për krime lufte në Hagë. "Në Hagë nuk janë duke u përndjekur vetëm individët, por as nuk mund të mbrohen të pandehurit sikur individë. Shteti i Kosovës duhet të organizojë dhe koordinojë mbrojtjen e të pandehurve. Ata i pamë se i kanë avokatët e tyre secili, por nevojitet bashkërendim nga shteti. UÇK-ja nuk ka qenë e asnjërit, por e të gjithëve dhe të gjithë duhet ta mbrojmë atë", ka thënë Kurti.

Në vitin 2015 Qeveria e Kosovës ka miratuar Ligjin për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar

potencialë në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara. Sipas këtij ligji, çdo i akuzuar ka të drejtën për ndihmë financiare dhe mbulim të shpenzimeve të mbrojtjes. "Të gjithë personat e akuzuar kanë të drejtën e kërkesës për asistencë për mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes dhe të angazhimit të mbrojtësit të pavarur, me përvojë dhe kompetencë, që paguhen nga buxheti i Kosovës, i alokuar për qëllimet e këtij ligji", thuhet në këtë ligj. Po ky ligj ua siguron mbulimin e shpenzimeve edhe familjarëve të tyre gjatë vizitave që do t'u bëjnë këtyre personave, të cilët do të përballen me procese gjyqësore në Hagë.

Deri më tani Gjykata Speciale ka konfirmuar akuzat ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Salih Mustafa. Para Speciales, ata po mbrohen nga avokatët të njohur ndërkombëtarë.

Në paraburgim në Hagë, edhe pse pa aktakuzë, aktualisht janë edhe udhëheqësit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.



Haradinaj kujton lirimimin nga Haga, beson në pafajësinë e bashkëluftëtarëve të tij

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER)- Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kujtuar lirimimin e tij nga çdo akuzë nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se tetë vite më parë u dëshmuua për të dytën herë pastërtia e luftës së UÇK-së.

Ai ka vlerësuar se beson në pafajësinë e bashkëluftëtarëve që sot përballen me sfidën e radhës në Hagë. "Tetë vite më parë u dëshmuua për të dytën herë pastërtia e luftës së UÇK-

së, e imja dhe bashkëluftëtarëve të mi. Populli i Kosovës pas gati një shekull dhune sistematike, kapi pushkët në mbrojtje të jetës dhe tokës së tij. Pastërtia e luftës së UÇK-së, mori përkrahjen e mbarë botës demokratike në krye me NATO-n. Andaj, besoj në pafajësinë edhe të bashkëluftëtarëve që sot përballen me sfidën e radhës në Hagë. Ata shkuan si çlirimtarë atje, ashtu do të kthehen. Historia shkruhet vetëm një herë!", ka shkruar Haradinaj.



Mbi 1 000 të vdekur nga Covidi në Kosovë

Kosovës të dielën i janë shtuar 626 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 505 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar 16 viktima. Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para me Covid-19 në Kosovë, autoritetet shëndetësore kanë raportuar për 39,057 të prekur nga ky virus. Prej tyre 1 005 pacientë kanë vdekur



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 NËNTOR- Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), janë testuar gjithsej 1 505 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 626 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar edhe 16 raste të vdekjes nga ky virus.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren tri raste (84, 79, 53 vjeç), Ferizaj dy raste (77, 47 vjeç), Gjakovë dy raste (80, 77 vjeç), Kamenicë dy raste (62, 54 vjeç), Malishevë dy raste (79, 67 vjeç), Suharekë dy raste (76, 70 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (77 vjeç), Lipjan një rast (70 vjeç), Podujevë një rast (83 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 39 057 raste nga 142 769 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 005 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 673 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 24 427 raste,

kurse numri i rasteve aktive është 13 625.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 237 raste, Mitrovicë 52 raste, Ferizaj 33 raste, Gjilan 32 raste, Prizren 29 raste, Podujevë 28

raste, Vushtri 27 raste, Lipjan 25 raste, Fushë-Kosovë 24 raste, Suharekë 19 raste, Skenderaj 17 raste, Gjakovë 15 raste, Kamenicë 13 raste, Shtime 13 raste, Drenas 12 raste, Rahovec 9 raste, Obiliq 8

raste, Viti 7 raste, Kaçanik 4 raste, Malishevë 4 raste, Graçanicë 3 raste, Klinë 3 raste, Pejë 3 raste, Dragash 2 raste, Shtërpçë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Deçan, Hani i Elezit, Istog dhe Novobërdë.

SBASHK-u kundër qeverisë, sot nuk ka mësim



PRISHTINË, 29 NËNTOR- Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës në Kosovë (SBASHK) ka dalë kundër vendimit të Qeverisë

së Kosovës që e hëna të jetë dite e zakonshme pune. SBASHK-u ka njoftuar se të hënën, me 30 nëntor, në shkollat e Kosovës nuk

do të zhvillohet mësimi për nder të festës së 28 Nëntorit. "Të premtën punëtorët arsimorë në fillimet e orëve të para të mësimi

kanë bashkëbiseduar me nxënësit për 28 nëntorin e flamurit kombëtar dhe të Komandantit legjendar Adem Jashari dhe pastaj kanë treguar se bazuar në Kalendarin për këtë vit shkollor, aprovuar nga MASH [Ministria e Arsimit] e hëna është ditë pushimi dhe kështu edhe do të jetë", thuhet në njoftimin e SBASHK-ut. Duke u thirrur në solidarizim me punëtorët shëndetësorë të cilët janë duke u përballur me luftën ndaj pandemisë së Covid-19, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se e hëna do të jetë ditë e zakonshme pune. Por, SBASHK-u bën thirrje që solidarizimi me punëtorët shëndetësorë të ndodhë me rastin e ndonjë feste tjetër. "Apeli a vendimi që të hënën të punohet në emër të solidaritetit me punëtorët shëndetësor le të

përdoret për ndonjë herë e për ndonjë festë tjetër e jo për festën e madhe të flamurit kombëtar", thuhet në njoftim.

Në njoftimin e SBASHK-ut thuhet se punëtorët e arsimit dhe nxënësit e meritojnë dhe duhet të pushojnë të hënën për ta ndjerë sado pak atmosferën festive e për të lartësuar kujtimin për heronjtë e dëshmorët e kombit.

Të premtën, më 27 nëntor, përmes një sqarimi për media, Qeveria e Kosovës, tha se në të gjitha institucionet shtetërore, në institucionet arsimore në të gjitha nivelet, do të punohet me orar të rregullt, në përputhje me masat anti-Covid të ndërmarra nga Qeveria.

Qeveria tha se ky vendim vjen si solidarizim me të gjithë ata të cilët janë në linjën e parë të frontit me pandeminë Covid-19.

Agim Bahtiri merr vendim për zbulimin e qytetit

MITROVICË, 29 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka bërë me dije se ka marrë vendim ta zbulojë qytetin pas kërkesave të qytetarëve. Bahtiri javë më parë kishte thënë se nuk do ta zbulojë qytetin, por duket se presioni i qytetarëve ia ka ndryshuar mendjen atij. "Duke i pasur

parasysh kërkesat e qytetarëve për zbulim të shesheve të qytetit për festën e Vitit të Ri dhe gatishmërinë e bizneseve për të kontribuar në këtë proces, ju njoftoj se kam marrë vendim që qyteti të zbulohet për fundvit. Mirëpo, për shkak të situatës së pandemisë dhe nevojave për menaxhimin e saj me paratë publike, asnjë cent i

komunës nuk do të shpenzohet për zbulimin e qytetit. Zbulimi i shesheve do të paguhet nga disa biznesmenë të cilat iu kanë bashkëngjitur iniciativës time që ky proces të kryhet me buxhet privat, ku unë do të jem i pari që do të participojë me para personale", ka shkruar Bahtiri në llogarinë e vet në "Facebook".



III. 'Plagjiatura' e Dick Martyt dhe e vërteta për raportin që mban emrin e tij



Shkruan: Bardhyl
MAHMUTI

Në pjesën e botuar paraprakisht dhe të titulluar "Dick Marty dhe propaganda serbe" theksova se pas dështimeve diplomatike për ta penguar shpalljen e pavarësisë së Kosovës, diplomacia serbe u mobilizua për ta paraqitur këtë shpallje si "vendim në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare".

Tri javë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Carla Del Ponte, e cila e kishte përfunduar mandatin që kishte si prokurore e përgjithshme në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe ishte emëruar ambasadore e Zvicrës në Argentinë që nga 1 janari i vitit 2008, i dha një intervistë ekskluzive për *Swissinfo*.

Në këtë intervistë, të publikuar më 11 mars 2008, Carla Del Ponte, në "cilësinë e juristes", këmbëngul, njëllon si propaganda serbe, se gjoja "pavarësia e Kosovës nuk është në përputhje me dispozitat e vendosura nga tradita e të drejtës ndërkombëtare".

Vetëm një ditë pas publikimit të intervistës së Carla Del Pontes, kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme të Këshillit të Shteteve të Konfederatës Helvetike, Dick Marty, në një intervistë ekskluzive me gazetaren Silvia Cattori, të publikuar më 12 mars 2008, u deklarua haptazi kundër pavarësisë së Kosovës dhe përvetësoi cilësimin serb për vendimin e Kuvendit të Kosovës që ta shpallë pavarësinë si vendim "në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare".

Krahas përvetësimit të interpretimit serb të së drejtës ndërkombëtare, Dick Marty shpreh revoltën e tij për prezantimin e "UÇK-së si një organizatë e virgjër dhe bamirëse" dhe këmbëngul në propagandën që e cilëson UÇK-në si "organizatë kriminale, që provokoi luftën, që vrau civilë të pafajshëm dhe që u shndërrua në instrument të amerikanëve për t'u mundësuar atyre në Kosovë krijimin dhe mbajtjen e bazës ushtarake më të madhe

në botë".

Në kontekst të mobilizimit kundër pavarësisë së Kosovës, botimi i librit autobiografik të Carla Del Ponte-s "Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës", më 11 prill të 2008-s, zë një vend të rëndësishëm.

Përkundër fakteve se gjatë periudhës kur kishte qenë prokurore e përgjithshme e Gjykatës Penale

Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, Carla Del Ponte kishte urdhëruar zhvillimin e hetimeve lidhur me pretendimet serbe për gjoja "trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja" dhe pas hetimeve të hollësishme disavjeçare kishte urdhëruar mbylljen e kësaj çështjeje duke e cilësuar si "legjendë e thjeshtë e sajuar njëllon si tregimet e ngjashme që shfaqen në zonat e tjera të konflikteve", Carla Del Ponte aktualizon këtë çështje në librin e lartpërmendur.

Ky libër i dha flakë propagandës kundër pavarësisë së Kosovës. Më 15 prill 2008 Serbia arriti që nëpërmjet deputetit rus në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Konstantin Kosachevi, ta dorëzojë propozimin për rezolutë lidhur me "trajtimin çnjerëzor të personave dhe tregtinë ilegale me organet e njerëzve". Projektrezoluta ishte nënshkruar nga 17 deputetë (1 serb, 2 rusë, 2 ukrainas, 1 azerbajxhanas, 1 georgjian, 1 polak, 1 hungarez, 1 qipriot, 1 belg, 1 zviceran, 1 britanik, 1 holandez, 1 portugez, 1 suedez dhe 1 finlandez).

Deputetët nënshkruar të këtij propozimi u mbështetën vetëm në thëniet e Carla del Pontes dhe në projekt-rezolutën e tyre citohet nga libri i saj për pretendimet se gjoja "Ushtria Çlirimtare e Kosovës në vitin 1998 kishte rrëmbyer më shumë se 300 serbë, romë, shqiptarë dhe pjesëtarë të grupeve të tjera etnike, të cilëve u ishin hequr organet vitale, që u dërguan nga Aeroporti i Rinasit në klinikat jashtë shtetit, për t'u transplantuar pacientëve që paguanin".

Një ditë pas kësaj projekt-rezolute, në sesionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të mbajtur nga 14 deri më 18 prill 2008, delegacioni parlamentar zviceran dhe ai suedez propozuan të hapet debat lidhur me "pasojat e shpalljes së pavarësisë së Kosovës". Gjatë debatit që u zhvillua më datë 16 prill 2008, një vend të

rëndësishëm zë fjala e Dick Martyt.

Në fillim të fjalës së tij, Dick Marty tërhoqi vërejtjen se "pas dhjetë vjet të administrimit ndërkombëtar, Kosova gjendet pa një shoqëri të mirëfilltë civile. Të gjithë ata që preokupohen me çështjen e kriminalitetit, e dinë se Kosova ka qenë gjithmonë, e ndoshta sot më shumë se dje, një qendër e kriminalitetit ndërkombëtar e kriminit të organizuar (...) gjendja ekonomike është katastrofale (...) minoritetet nuk mund të jetojnë në Kosovë, pos të mbrojtur nga trupat e huaja..." Dhe, kuptohet, këtë gjendje të keqe, sipas tij, e krijoi pikërisht ndërhyrja

ndërkombëtare në Kosovë dhe mosrespektimi i së drejtës ndërkombëtare. "Kjo filloi me bombardimet e NATO-s, bombardime në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, që u bënë pa miratimin e Këshillit të Sigurimit (...) dhe pas shkëlqes flagrante të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit që garantonte integritetin territorial të Serbisë...!"

Këto diskutime zgjuan interesim të madh në kuadër të Komisionit për Çështjet Juridike dhe të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës. Pas fjalës së mbajtur në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës më 16 prill 2008, ky komision ngarkoi Dick Martyn të përpilonte një raport për këtë çështje.

E revoltuar nga manipulimi politik i kësaj çështjeje dhe nga përfshirja e Carla Del Pontes në përhapjen e propagandës serbe, reagoi Florence Hartmann, ish-zëdhënësjë e prokurores së përgjithshme. Në një shkrim të publikuar në gazetën "Le Temps", të datës 16 prill 2008, dhe të titulluar "Carla Del Ponte

dhe thashethemet për trafikimin me organe në Kosovë", Florence Hartmann shpreh habinë e vet se "si është e mundshme që Carla Del Ponte, puna e së cilës konsistonte që të kërkohet e vërteta, përkundër pengesave, dhe në këtë mënyrë të luftohet mohimi dhe manipulimi, sot të na fundosë në kohën më të errët të propagandës... Të flitet sot, përderisa për pesë vjet nuk u soll asnjë element i ri që do ta mbështeste këtë tezë, është papërgjegjësi" deklaroi ish-zëdhënësjëja e Carla Del Pontes. Aktualizimin e një çështjeje të mbyllur para pesë vjetësh, të mbyllur për arsye se nuk u gjet as prova më e vogël, u bë me qëllim të mbështetjes së fushatës serbe për ta mohuar legjitimitetin e vendimit për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Paralelisht me fushatën kundër pavarësisë së Kosovës, Serbia mori kontakte me Dick Martyn, të ngarkuarin e Këshillit të Evropës për ta hartuar raportin rreth pretendimeve për "tregtinë ilegale me organe njerëzore në Kosovë".

Në analizën që i kam bërë raportit që mban emrin e Dick Martyt, që gjerësisht përfshihet në librin "Mashtrimi i madh", kam nxjerrë në shesh se ky raport nuk ka asgjë tjetër pos sajësive të Shërbimit Sekret Serb, prandaj vendosja e emrit të Dick Martyt në një raport të tillë është "plagjiaturë" e padiskutueshme.

Katër vjet pas publikimit të librit tim, "plagjiatura" e Dick Martyt u ndriçua tërësisht. Më 24 tetor të vitit 2018, gjatë përrurimit të librit të tij të titulluar "Vendi i Wilhem Telit", në televizionin serb "TV HAPPY", ish-ambasadori i Serbisë në Zvicër, Milan St. Protiq, rrëfen për mënyrën si AI PERSONALISHT

IA KA DHËNË DICK MARTYT "provat e përgatitura nga institucionet e Serbisë për trafikimin e organeve dhe për Shtëpinë e verdhë".

Publiciteti që iu dha në mediat ndërkombëtare propagandës serbe për gjoja "tregtinë me organe njerëzore në Kosovë" u ngjalli shpresa të mëdha se mund ta kthenin mbrapa rrjedhën e ngjarjeve lidhur me pavarësinë e Kosovës.

Pas gjashtë muajsh fushatë historike kundër UÇK-së dhe të trimëruar nga qëndrimet e qarqeve antiamerikane që shihnin "në shtetin e Kosovës bazën më të madhe ushtarake të ShBA-së në botë", Serbia ndërmori iniciativën për të gjetur mbështetje në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Në sesionin e 63-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të datës 8 tetor 2008, ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Vuk Jeremi i, shtroi për miratim një projekt-rezolutë nëpërmjet së cilës kërkohet që kjo asamble ta kërkonte mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Po atë ditë, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi rezolutën që kërkonte nga gjykata e lartpërmendur përmes së cilës kërkoi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë mendim konsultativ dhe t'i përgjigjej pyetjes: "A është shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?" Të nesërmen, më 9 tetor 2008, sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Mooni, ia dërgoi këtë kërkesë kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

(VIJON)



Kush qëndron prapa të ashtuquajturit „Raport i Dick Martyt“?

Gjermania do të marrë 180 miliardë euro borxhe të reja për vitin 2021

BERLIN, 29 NËNTOR- Komisioni për Buxhetin në Bundestag u takua për shtatëmbëdhjetë orë e gjysmë, për të hartuar Projektbuxhetin e vitit 2021. Propozimi tani është gati. Koalicioni i madh dëshiron të marrë gati 180 miliardë euro borxhe të reja gjatë vitit të ardhshëm. Si pasojë e krizës së Covid-19 për shëndetësi, transport dhe infrastrukturë nevojiten shumë më shumë para sesa ishte planifikuar, kështu vendosi Komisioni për Buxhetin në Berlin.

Në Buxhetin Federal për vitin 2021 do të ketë 498.6 miliardë euro, që është një dallim shumë i vogël krahasuar me këtë vit kur për shkak të pandemisë është vendosur me procedurë të përshtetshme që të financohen programe të shumta të ndihmave në vlerë prej dhjetëra e qindra miliarda euro.

Bundestagu duhet ta miratojë këtë dokument në javën e dytë të dhjetorit.

Gjatë konsultimeve 17-orëshe është vendosur që të bëhen ndryshime të shumta nga buxheti i propozuar prej ministrit të Financave, Olaf Scholz (SPD) në muajin shtator. Ky propozim parashikonte 96.2 miliardë borxhe të reja. Por në fillim të kësaj jave ishte e qartë se për shkak të mbylljes së pjesshme në muajt nëntor dhe dhjetor, do të duhen edhe borxhe të reja për të



tejkuluar këtë gjendje. Tani flitet edhe për 39.5 miliardë euro të tjera, si ndihma të përkohshme për ndërmarrjet. Ndërsa për vaksinën kundër Covid-19 do të nevojiten të paktën edhe 2.7 miliardë euro.

Shuma të mëdha do të ndahen edhe për lehtësimin e gjendjes në buxhetet familjare. Vitin e ardhshëm ato nuk do të paguajnë taksat për solidaritetin, ku është ulja më e madhe e tatimeve vitet e fundit. Përveç kësaj, familjet për

çdo fëmijë do të marrin edhe 15 euro shtesa në muaj. Për të gjithë taksapaguesit do të rritet shuma e të ardhurave, për të cilat nuk nevojë të paguhet tatime.

Siç thotë eksperti i Unionit CDU/CSU për buxhetin, Eckhardt Rehberg, buxheti i vitit 2021 është tërësisht nën hijen e pandemisë Covid-19. "Borxhet e larta janë të nevojshme për ta kaluar vendin tonë në këtë pandemi shekullore. Kjo nënkupton shkeljen e rregullave

për mosfutjen në borxhe. Por edhe niveli i borxheve federale ka një kufi", ka theksuar Rehberg.

Eksperti i ekologjistëve për buxhetin, Sven-Christian Kindler po ashtu thotë se marrja e borxheve të reja është politikë e mirë. Por buxheti i koalicionit të madh dëshmon një çekuilibrim shoqëror dhe lë të papunët si dhe ndërmarrësit private në shi. Investimet për industrinë ekologjike janë tepër të ulëta. Në vend të kësaj, qeveria federale po

shpëton koncernet e mëdha që fitojnë para me lëndë djegëse fosile.

Eksperti liberal Otto Fricke kritikoi vendimin për marrjen e kredive të larta. Partitë në pushtet do të merrnin dy herë më shumë borxhe sesa ishte e nevojshme.

Fricke kritikoi koalicionin. Ai thotë se kurrë më parë nuk janë marrë kaq shumë borxhe në një kohë kaq të shkurtër.

/Deutsche Welle/

Reçica: Me Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike po bëhet politikë

PRISHTINË, 29 NËNTOR- Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se me Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike po bëhet politikë. Ai ka thënë se si pasojë e pandemisë, është dyfishuar numri i të papunëve. "Projektligji për rimëkëmbje është një mekanizëm që i mundëson qeverisë që të jetë sa më afër qytetarit. Tash ne jemi dëshmitarë që edhe përkundër planifikimit të buxhetit për rimëkëmbje ekonomike, ne atje bëjmë garë politike në Kuvend dhe kjo është fatkeqësia", ka thënë Reçica në "Klan Kosova".

Ai ka shprehur besimin se në seancën e parë ky projektligj do të gjejë dritën e miratimit nga të gjithë deputetët. "Dua të nënvizoj, në këto rrethana kur ne po ballafaqohemi me pandeminë dhe sfida të tjera, askush nuk mund t'i ikë përgjegjësisë. Shpresoj që tashmë ky projektligj në seancën e radhës do të gjejë përkrahjen e deputetëve me qëllim që t'u ofrojmë qytetarëve mbështetje



që duhet ta ofrojmë në këtë kohë pandemie", është shprehur ministri Reçica.

Ai ka thënë se refuzimi i disa prej deputetëve për ta votuar Projektligjin për rimëkëmbje

ekonomike po bëhet për garë politike. "Ne jemi dëshmitarë që në këtë kohë të pandemisë edhe ekonomitë e shteteve më të zhvilluara janë gjunjëzuar. Natyrisht se kur flasim për

ekonominë e vendit tonë është goditur dhe është dëmtuar sektori privat në veçanti. Kur kemi tkurrje të zhvillimit ekonomik, natyrisht se ka edhe humbje të vendeve të punës. Para

se të fillojë kjo situatë, ka qenë numri i të regjistruarve si të papunë rreth 100 mijë, ndërsa tani kemi rreth 200 mijë", ka thënë ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica.

Humbje miliardëshe, ndihmë milionëshe



Nga rreth 1 miliard euro humbje sa vlerësohet se shënuan bizneset në Kosovë gjatë pandemisë me Covid-19, Qeveria e Kosovës, deri më tani, i ndihmoi ata me vetëm rreth 150 milionë euro

PRISHTINË, 29 NËNTOR- Në pakon emergjente të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej rreth 180 milionë eurosh, bizneset gëzuan një mbështetje financiare prej mbi 60 milionë euro. Me këto mjete ishte paraparë mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170 eurosh për dy muaj, subvencioni i qirasë deri në 50 për qind të vlerës e të tjera.

Ndërkaq, nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike i Qeverisë së Kosovës, i cili kap vlerën e më shumë se 350 milionë eurove, u ndanë 60 milionë euro për biznese, në bazë të listës së numrit të punëtorëve. Nga kjo shumë përfituan rreth 36 mijë biznese me më shumë 200 mijë të punësuar. Bizneset kanë përfituar nga 290 euro për secilin punëtor të punësuar.

Por, krahasuar me ndihmën që ka dhënë shteti për bizneset, humbjet janë shumë herë më të mëdha.

Vetëm, sipas të dhënave të fundit të Administratës Tatimore të Kosovës, bizneset në Kosovë kanë pasur afër 1 miliard euro më pak qarkullim gjatë periudhës së pandemisë, krahasuar me vitin e kaluar.

Të hyrat e aktiviteteve ekonomike që u prekën më së shumti nga pandemia Covid-19,

sipas një hulumtimi të bërë nga Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP është industria e ndërtimit, pasuar nga tregtia, transporti, akomodimi dhe gastronomi.

Zhvillimet e pafavorshme në ekonomi janë reflektuar edhe në të hyrat buxhetore, ku sipas Ministrisë së Financave në Qeverinë e Kosovës deri në fundin e vitit 2020, do të ketë rreth 300 milionë euro më pak të hyra për buxhetin e Kosovës.

Humbjet e bizneseve në Kosovë nisën që nga vendosja e masave të para për parandalimin e përhapjes së koronavirusit më 13 mars, atëherë kur edhe u shënuan rastet e para me koronavirus në Kosovë.

Për këta tetë muaj bizneset deklaruan për humbje të mëdha. Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës, Odës Ekonomike Amerikane, Aleancës Kosovare e Biznesit, Odës së Afarizmit dhe shumë organizata tjera ekonomike kërkuar ndihmë nga qeveria për bizneset, por, që ndihma që shteti ndau, u vlerësua se nuk ishte e mjaftueshme.

Përveç ndihmës, e cila ishte e pamjaftueshme, autoritetet e Kosovës dështuan edhe të miratojnë Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike, që ka

për qëllim t'i ndihmojë bizneset që kanë pasur humbje nga pandemia Covid-19.

Ky projektligj, pas gjashtë dështimesh për miratim në Kuvendin e Kosovës, ka arritur të miratohet vetëm në lexim të parë më 13 korrik.

Në këtë Projektligj, është paraparë që "Fondi Kreditor Garantues i Kosovës, (FKGK) të autorizohet që të lëshojë garanci kreditore me përqindje të mbulesës nga 50 deri në 80 për qind". Gjithashtu, kontribut-paguesit mund t'i tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Komuniteti i biznesit paralajmëroi krizë financiare te bizneset deri të falimentimi i tyre, nëse nuk miratohet ky ligj dhe bizneset nuk ndihmohen nga shteti.

Pandemia mbylli biznese

Gjatë periudhës shkurt - tetor, sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë, janë mbyllur 761 biznese, të cilat kanë pasur të punësuar 1,316 punëtorë. Numri më i madh i bizneseve zyrtarisht të mbyllura kanë punuar në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, pasuar nga industria përpunuese, hoteleria dhe akomodimi. Në listën e bizneseve të mbyllura figurojnë edhe biznese në fushën e ndërtimit, informimit dhe komunikimit dhe sektorë të tjerë. Por, numri i bizneseve të mbyllura u konsiderua të jetë më i lartë nga Oda e Afarizmit të

Kosovës. Sipas të dhënave të kësaj organizate jo të gjitha bizneset, të cilat kanë shuar aktivitetin e tyre gjatë pandemisë, kanë filluar procedurat e mbylljes. "Numri i bizneseve që sot nuk po funksionojnë janë me mijëra", pati thënë për "Radion Evropa e Lirë", drejtori i kësaj shoqatë Skender Krasniqi.

Niveli i papunësisë është rritur gjatë periudhës së pandemisë. Masat për parandalimin e koronavirusit ndikuan që shumë biznese të reduktojnë numrin e të punësuarve. Numri i saktë i personave që kanë humbur vendin e punës nuk dihet, por Oda e Ekonomike e Kosovës dhe ajo e Afarizmit kanë thënë se kemi të bëjmë me rreth 30 mijë të punësuar që gjatë pandemisë mund të kenë humbur vendin e punës.

Numri i qytetareve të regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit, shënoi rritje në këtë periudhë. Sipas të dhënave të APK-së numri total i të regjistruarve si të papunë deri në korrik është mbi 180 mijë. Papunësia në Kosovë në vitin 2019 ishte 25.7 për qind.

Ekonomia e Kosovës, rënie në rreth 7.2 për qind

Sipas parashikimeve të Bankës Qendrore të Kosovës, ekonomia e vendit këtë vit pritet të shënojë rënie prej rreth 7.2 për qind si rezultat i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19, të cilat ndikuan negativisht në pothuajse të gjitha

aktivitetet ekonomike në vend. Ndërkohë, raportet e BQK-së vënë në pah se sistemi bankar i Kosovës është mjaft mirë i kapitalizuar dhe likuid.

Bankat komerciale në Kosovë, sipas të dhënave të BQK-së, vazhdojnë të kreditojnë ekonominë e Kosovës. Gjithsej kreditë në muajin gusht 2020, sipas BQK-së, janë në shumën prej 3.02 miliardë eurove, duke vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë këtij viti, me një rritje vjetore prej 7.6 për qind.

Instituti GAP në hulumtimin e tij thotë se vazhdimi i kredidhënies është i domosdoshëm në mënyrë që të mundësohet stimulimi i konsumit të ekonomive familjare dhe investimet në sektorin privat.

Megjithatë, sipas GAP-it, në muajt në vijim kur pritet që gjendja e sektorit privat të vështirësohet edhe më tutje, fakti se bankat komerciale janë likuide dhe me kapital të lartë mund të jetë i pamjaftueshëm për të vazhduar kreditimi.

Bankat mund të vlerësojnë se ekziston një ambient i rrezikshëm për ofrim të kredive të reja dhe si rezultat të reduktojnë kreditë e reja edhe më shumë.

Në këtë situatë, GAP sugjeron që Fondi Kosovar për Garanci Kreditor mund të luajë një rol kyç në marrjen përsipër të një pjese të rrezikut dhe të mundësojë vazhdimin e kredidhënies. Fonde të ngjashme u treguan efektive në shumë vende të botës gjatë krizës globale financiare.

Lladrovci thotë se sot do të punohet në Drenas

DRENAS, 29 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka njoftuar se Departamenti i Arsimit, drejtorët e shkollave, personeli arsimor dhe administrata komunale do t'i përmbahen vendimit të qeverisë që sot (e hënë) të dalin në punë, duke respektuar masat e parapara për pengimin dhe luftimin e virusit Covid-19. Lladrovci ka thënë se dilemat e hapura për të hënë, janë për keqardhje, kur dihet vendimi i qeverisë, duke theksuar se vendimi do të respektohet pavarësisht bindjeve politike. "Qytetarë të Komunës së Drenasit, e hëna është ditë pune, në pajtim me vendimin e qeverisë. Ky muaj ishte tepër i rëndë, për tërë vendin, edhe për qytetarët e

komunës tonë. Andaj, më shumë se çdo herë, na duhet unitet në vendime dhe zbatimin e tyre. Departamenti i Arsimit, drejtorët e shkollave, personeli arsimor dhe të gjithë zyrtarët e këtij procesi, do t'i përmbahen vendimit të Qeverisë se e hëna është ditë pune, ashtu si për administratën e komunës tonë, duke respektuar masat e parapara për pengimin dhe luftimin e virusit Covid-19. Dilemat e hapura për të hënë, janë për keqardhje, kur dihet vendimi i Qeverisë. Vendimi do respektohet, pavarësisht bindjeve politike. Nuk është kohë as gjendje për të krijuar precedent në Republikën e Kosovës, thjeshtë, na duhet unitet, për gjithçka!", ka thënë Lladrovci.



Haziri: Gjendja me Covid në Gjilan vazhdon të jetë alarmante

GJILAN, 29 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë përkundër që javën e fundit ka pasur rënie të rasteve me koronavirus dhe me shumë të shëruar, situata në këtë qytet vazhdon të jetë alarmante. Me këtë rast, ai u ka bërë thirrje qytetarëve të kësaj komune që t'i zbatojnë masat anti-Covid. "Dita e 265. Përkundër që javën e fundit kemi ulje të rasteve dhe më shumë të shëruar, situata në Gjilan vazhdon të jetë alarmante. Ju lutem që t'i zbatoni rekomandimet sepse bartja e maskës, higjiena dhe distanca, janë masat e vetme që nuk lejojnë bartjen e infektionit. Vizitat dhe pritjet për ngushëllime janë të ndaluara. Përkundër



traditës dhe dhimbjes, mos fjinjet dhe familjarët", ka thënë Haziri.

Kastrati ndan mirënjohje për OVLUÇK-në e Kamenicës

KAMENICË, 29 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me nënkryetarin Faton Jakupi, drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Arianit Ibrahim, kryetarin e Degës së OVLUÇK-së në këtë komunë, Milaim



Limani, është takuar me grupin e parë të UÇK-së nga Zona Operative të Karadikut. Ky takim është bërë pas 21 viteve për nder të festës së 28 Nëntorit. Kastrati, për nder të kësaj dite ka ndarë mirënjohje për OVLUÇK-në në Kamenicë. "Pas 21 viteve sot bashkuam grupin e parë të Zonës

Operative të Karadikut të cilët ishin në Shqipëri për armatim dhe furnizim të UÇK-së. Në këtë 28 nëntor pata kënaqësinë që ditën ta nisim me homazhe tek ata që s'janë fizikisht me ne dhe të vazhdojë me veteranët e UÇK-së. Për nder të kësaj dite, sot ndava mirënjohje për OVLUÇK në Kamenicë", ka thënë Kastrati.

QKMF-ja e Ferizajt nga korriku ka realizuar 1 266 shërbime radiologjike

FERIZAJ, 29 NËNTOR (ER)- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Ferizaj ka bërë me dije se nga muaji korrik janë kryer 1 266 shërbime radiologjike. Kjo qendër ka lavdëruar punën e stafit të shërbimit të radiologjisë dhe diagnostikës, të cilët me profesionalizëm u kanë dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të cilët kanë pasur nevojë. "QKMF-ja vazhdon përballjen e suksesshme me Covid-19 në të gjithë sektorët e saj. Një prej tyre është edhe shërbimi i radiologjisë dhe diagnostikës që po kryen me përkushtim të gjitha shërbimet e nevojshme karshi kërkesave të qytetarëve. Ky staf profesional krahas

shërbimeve të pacientëve të QKMF-së po i del në ndihmë edhe spitalit të përgjithshëm të Ferizajt me resurse njerëzore dhe teknike. Që nga muaji korrik në kabinetin E RTG-së janë realizuar mbi 1266 shërbime radiologjike për pacientët e prekur me Covid-19, duke mos lënë anash edhe pacientët me probleme të tjera shëndetësore. Këtij dhe shërbimeve të tjera të QKMF-së mund t'i ndihmojnë edhe qytetarët me kujdesin ndaj vetes dhe të tjerëve duke i respektuar me përpikëri rekomandimet për mbrojtje nga infeksioni, prandaj mos hezitoni të ndihmoni veten dhe të tjerët", ka njoftuar QKMF-ja e Ferizajt.



Tendenca për ngritjen e termocentraleve nga gazi, intrigë e rrezikshme e politikës qeveritare



Nga: Prof. Dr. Izet
IBRAHIMI

Për derisa kryeministri polak këtu e gjashtë vite më parë konstatonte se “varësia prej gazit rus dobëson Evropën”, dhe kërkonte, nga shtetet e BE-së t’i shfrytëzojë plotësisht burimet e energjisë fosile si qymyrin dhe gazin shist argjilor, kryeministri i Kosovës gjatë këtij viti ka filluar të përpëlitet që të bëjë të kundërtën. Ai, së bashku me Zajevin maqedonas siç po thotë: “Prishtinën do ta lidhim me gazin rus në Shkup, dhe përmes projektit Aleksandropoli do ta transformojë komplet regjionin dhe më gjerë sa i përket furnizimit me energji dhe stabilitetit të mbarë regjionit”.

Në fund të vitit të kaluar në politikë u rindez një debat i gjerë mbi reduktimin e varësisë së vendeve të BE-së nga furnizimet me gaz natyror nga Rusia. U ricitua në shumë debate deklarata e kryeministrit polak Tusk, i cili në vitin 2014 deklaronte se “varësia prej gazit rus dobëson Evropën”. Tusk me këtë rast kërkonte “që shtetet e BE-së të bashkëpunojnë më ngushtë në politikën energjetike dhe në furnizimin me gaz dhe naftë. Përveç kësaj ai thërriste që BE-ja duhet t’i shfrytëzojë plotësisht burimet e energjisë fosile si qymyri dhe të shfrytëzojë plotësisht gazin shist argjilor, që është i diskutueshëm”. Por megjithatë, edhe përkundër kësaj dhe faktit se edhe në të ardhmen thëngjilli, po del te jetë burim më i lirë, i sigurt dhe efektiv për prodhimin e energjisë elektrike, qeveria Hoti, e mbështetur edhe nga një grushti oligarkësh dhe “ambientalistësh” përmes lansimit të idesë së ngritjes së termocentraleve me gaz, po përpiqet që ta minimizojë rolin strategjik të linjtit të Kosovës, si dhe të rris rolin e gazit natyror për ngritjen e kapaciteteve të reja të energjisë. Tani më, është e dëshmuar, se jo vetëm kostoja prodhuese, por kapacitetet e energjisë nga linjiti, përveç që do të ishin mundësia e vetme, që Kosova të mirëmbajë dhe rikthejë konkurrencën, ato do të garantojnë çmime transparente dhe reflektuese të tregut, do të krijojnë mundësitë që sektori të mos varet nga ndërsubvencionimet, të krijojë një sistem i sigurt me konsumatorë që mbështesin investimet e nevojshme përmes tarifave të tyre, dhe mbi të gjitha do të ishte një kontribut i ndjeshëm në uljen

e varësisë së BE-së nga gazi rus. Sipas Jean Monnet, një nga themeluesit e BE-së, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, kur, u vendos që ‘instrumentet e luftës të vendosen në shërbim të paqes’, thëngjilli dhe çeliku, si dhe energjia bërthamore ishin pikënisja për traktatet e para evropiane. Në suazat e kësaj porositë brilante të Jean Monnet, Kosova para çdo politike tjetër do të duhej që të promovonte resurset e saj energjetike, si instrument për forcimin e këtyre traktateve, ngase jo vetëm që ka rezerva të mëdha të linjtit (mbi 12 miliardë ton, vendi i tretë në Evropë me rezervat më të mëdha pas Gjermanisë dhe Polonisë), por ajo, kufizohet me katër vende të rajonit të cilat që të gjitha janë të kufizuara me vende anëtare të BE-së, duke e bërë atë vend të rëndësishëm për bartje të energjisë në rajon dhe përgjithësisht në tregun energjetik të BE-së.

Në parim, energjia elektrike dhe gazi mund të rrjedhin lirshëm nëpër rrjetet që shkojnë kryq e tërthor Evropës. Në një treg të vetëm evropian të energjisë, të gjithë prodhuesit dhe furnizuesit konkurrojnë me njëri-tjetrin. Prandaj, teoretikisht është e mundur që të blihet dhe shitet energjia elektrike dhe gazi kudo që ju dëshironi, duke pasur si qëllim marrjen e energjisë me cilësi të lartë dhe me çmim më të përshtatshëm. Ky do të ishte një plan i mirë në letër, megjithatë, sipas asaj që po zhvillohet në teren, arritja e këtyre caqeve është ende larg realitetit. Shembulli më eklatant është kriza e Ukrainës. Si përgjigje ndaj kësaj krize dhe duke pasur parasysh rëndësinë e përgjithshme të një furnizimi të qëndrueshëm, Evropianët që janë të famshëm për prirjen e gjelbër po shqetësohen nga fakti i mirëmbajtjes së konkurrencës, dhe funksionimit të një tregu të vetëm evropian të energjisë. Ato në pikun e krizës ukrainase deklarorin se kontinenti ose mund të jetë i pastër, ose mund të jetë i konkurrues. Kështu paralelisht me energji alternative janë duke hedhur dhjetëra miliardë euro në energjinë nga lëndët djegëse fosile.

Për fatin tonë të keq, Kosova është ende larg këtyre ambicieve, ngase edhe pse ka rezerva kaq të mëdha të linjtit, prej vitit 1984 nuk ka pasur asnjë investim në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese ose rehabilitim substancial të termocentraleve ekzistuese, si rezultat i të cilës asaj i mungon furnizimi stabil me energji. Pra, në kohën kur në vendet evropiane siç janë Gjermania, Polonia, Republika Çeke, Greqia, Bullgaria dhe Sllovenia, linjiti vazhdon të zë një pjesë të rëndësishme në sektorin energjetik, kryeministri kosovar Hoti, me kryeneçësinë e tij

ortodokse këtyre ditëve po promovon ngritjen e termocentraleve nga gazi rus si dhe shmangien nga projektet “energji nga linjiti”, dhe atë në emër të “energjisë së lirë dhe të pastër”. Pra pikërisht në kohën kur, është rindezur debati në vendet e BE-së për uljen e vartësisë energjetike nga Rusia, ai dhe zëvendëskryeministrja Balaj, për të dëshmuar verbësinë dhe varësinë e tyre politike kanë kopjuar fjalë për fjalë parullën e Zajevit maqedonas, “përmes projektit Aleksandropoli do ta transformojë komplet regjionin dhe më gjerë sa i përket furnizimit me energji dhe stabilitetit të mbarë regjionit”. Pra, pikërisht në kohën kur Hoti, Balaj dhe e gjithë nomenklatura qeveritare e Republikës së Kosovës do të duhej të punonte në eliminimin e barrierave të vena nga Serbia dhe aleatet e saj lidhur me shtrirjen e autoritetit në gjithë rrjetin e shpërndarjes, që të eliminojë barrierat politike për të qenë pjesë e Burses Shqiptare të Energjisë, dhe shfrytëzimit të interkonesionit 400 kV me Republikën e Shqipërisë, ai pa fije turpi me rastin e vizitës në Shkup, deklaronte se, “Prishtina do të lidhet me gazin në Shkup, me mbështetje të partnerëve tanë ndërkombëtarë...”. Kjo nuk është rastësi, e as paqartësi, në kohën kur Serbia dhe aleatet e saj në Bruksel suksesshëm po arrijnë të pengojnë shfrytëzimin e interkonesionit 400 kV, kryeministri Hoti po promovon stacionin e dytë më të madhin, pas atij në Serbi të lundrimit për magazinimin dhe gazifikimin e gazit të rrjedhshëm natyror, i cili për mes Korridorit 8 do të sjellë gazin rus edhe në Kosovë. Pra pikërisht në kohën kur projekti TAP po përmbyllte debatin lidhur me rrjetin e propozuar të transmetimit të gazit, i cili si rrjet do të mund të ndahet në pesë degë kryesore, ku ajo e pesta është dega e Kosovës, që fillon nga Miloti dhe përfundon në pikën kufitare të Morinës, në afërsi të Kukësit, Hoti po i tregon e Republikës së Kosovës (të cilës i referohet si Prishtinë) se gjurma e gazsjellësit ruso-turko-serbe “është më e lirë dhe më e pastër” se sa gjurma e gazsjellësit Trans Adriatike e cila ndjek linjën energjetike, Greqi, Itali, Shqipëri. Pra pikërisht kur Kosovës me urgjencë i nevojitet hartimi një baze ligjore dhe rregullatore e cila do të drejtonte implementimin e “Pakos së tretë të Energjisë”, pa të cilën nuk mund të ketë hapje të tregut, integrim në tregun ndërkufitar dhe modernizimin e sektorit të energjisë, e që njëkohësisht do të nxishte edhe prodhimin e energjisë së ripërtërishme, kryeministri Hoti nën parullën “energji e lirë dhe e pastër” propozon ngritjen e

Termocentraleve nga gazi. Pra në vend të krijimit të mjedisit për një progresi teknologjik, dhe kalimi në një regjim të ri energjetik, ai thjeshtë po promovon kalimin në një regjim të vjetër, sepse po kalon nga djegia e thëngjillit si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë në një hidrokarburin tjetër (gazi natyror) i cili nuk shquhet me ndonjë diferencë të lartë ndotje nga linjiti i Kosovës. Me këtë rast vlen të theksohet edhe kjo; edhe vendet me prirje të famshme për prodhimin e energjisë së pastër kanë dështuar në arritjen e caqeve të tyre projektuese. Kështu që edhe përkundër iniciativave të vendeve të ndryshme për të prodhuar vetëm energji të gjelbër, konsumi i thëngjillit në botë ka shënuar rritje prej 1.5 për qind në vitin 2018 dhe ka tendencë rritje në vitin 2019.

Ja disa fakte; vetëm në ShBA në vitin 2018, janë djegë 943 milionë ton thëngjill. Kurse Kina, djeg 4 miliardë ton thëngjill në vit, aq sa djeg e gjithë pjesa tjetër e botës. Gjermania nxjerr rreth 172 milionë ton thëngjill në vit, nga i cili vije 40 për qind e prodhimit të energjisë kundrejt mesatares evropiane prej 23 për qind. 150 termocentralet e saj me qymyr, ku së bashku me impiantet e tjera me naftë, çlirojnë shifrën e frikshme prej 256 milionë tonë CO2, që është një rekord absolut në Evropë. Në Britani, termocentrale të vjetra të bazuara në qymyr po riaktivizohen për të mbuluar mungesat e prodhimit nga projektet e energjisë së ripërtërishme. 30 termocentraleve të reja që djegin qymyr që po planifikohen të ndërtohen në Japoni. Në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë (Republikën Serbe), kompanitë kineze janë përfshirë në ndërtimin e 4950 MW energji nga thëngjilli. Projekte këto ambicioze, që në përfundim shihet si një përpjekje nga Kina për të rritur globalisht ndikimin ekonomik.

Por edhe përkundër kësaj, në Kosovë që nga koha e UNMIK-ut dhe në kontinuitet janë instaluar politika shkatërruese në sektorin e energjisë. Në vitin 2003, nën të ashtuquajturin ‘ristrukturim i Korporatës Energjetike të Kosovës’, janë shkatërruar - shitur për skrap kapacitetet gjeneruese prej 41 MW të energjisë nga linjiti, e të cilat operonin në kuadër të “NJ.P. “Ngrohtorja dhe Tertorja”, ndërsa në kuadër të të ashtuquajturit “dekomisionim i TC Kosova A” po punohet për mbylljen e kapaciteteve të instaluar prej 660, përfshirë 452 MW, që aktualisht kanë një disponueshmëri të lartë teknike-teknologjike. Pra në kohën kur Qeveritë e Vendeve të BE-së po punojnë dhe sugjerojnë se duhet t’i shfrytëzojë plotësisht burimet e energjisë fosile, Qeveria e

Kosovës për interesat e një grushti oligarkësh, po punon me zell për zhvlerësimin e termocentraleve nga linjiti, si dhe me investimet e saj dhe KEK-ut në zhvillimin e “minierës së re” të linjtit, po tenton të minimizojë rolin e linjiti si resurs energjetik. Pra, dekomisionimi/shkatërrimi, dhe ngritja e “minierës së re”, sipas projeksioneve të para financiare, do të kërkojë një investim të njëkohshëm prej 2 - 3 miliardë Euro gjatë 10 viteve të ardhshme. Por, e keqja nuk qëndron vetëm këtu, me politikën e tilla klienteliste, Kosova përveç që brenda një kohe të shkurtër do të humbas 40 për qind të kapaciteteve të saj gjeneruese, ajo përmes projektit “Zhvillimi i Minierës së Re të KEK-ut”, (projekt ky i dizajnuar një ish-student i Moskës, i cili parasheh braktisjen e pronës publike dhe kalimin 100 për qind në pronë private e blerë paraprakisht prej oligarkëve nga fshatarë të varfër), do të dekurajonte investimeve të jashtme, nga se përmes përshtatjeve dhe garantimit të çmimeve si dhe vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese me vendime politike do të eliminonte parimet e ekonomisë së tregut. Tendencat për zhvillimin e “Minierës së re në fushën Private” dhe shfrytëzimi i “Fushës Jug” si fushë potenciale për hedhjen e djerrinës, do të varroseshin përgjithnjë 580 milion, (gjegjësisht 1.1 miliard) ton rezerva linjiti, që shprehur me dinamikën e planifikuar të gjenerimit të energjisë, i bie “shkurtim eksplotimi me jetëgjatësi mbi një shekull”. Kur kësaj i shtohen edhe investimet për sisteme dhe pajisje, cilat duhet të përshtaten me infrastrukturë, parime e pajisje e sisteme tjera për fushën e re, si dhe marrë parasysh kostot dhe kushtet që do të imponojnë këta oligarkë për shpronësime të tokës, pemishteve, dhe të tjerave, atëherë projekti së paku sipas praktikave të deri tashme, do të rrezikojë stabilitetin financiar e social të shtetit. Kështu që në kohën kur sektorit të energjisë po i bëhet goditja më e rëndë, përmes projekteve për zhvlerësim të rëndësishëm strategjike të linjiteve të Kosovës në tregun energjetik Evropian, zyrtarët e Korporatës Energjetike të Kosovës në vend që të mbrojnë interesat e kompanisë së tyre, sektorit të energjisë dhe përgjithësisht Kosovës, nën heshtje që vret, po implementojnë politika që në një të ardhme të afërt do të rezultojnë me një nga dëmet me kolosale të shkaktuara në bilancin e rezervave minerale, dhe përgjithësisht shanseve zhvillimore, duke gllabëruar në mënyrën ma ekstreme perspektivën e shumë gjeneratave në vijim.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita fiton me përmbysje ndaj Gjilanit

Drita me përmbysje e fitoi derbin më të madh në Kosovë kundër Gjilanit (2-3), dhe ka vetëm dy pikë me pak se Ballkani që sot takohet me Arbërinë. Gjilani me dy humbjet e fundit ka bërë një hap pas në garën për titull të kampionit në Superligë. Të dielën fitores i është gëzuar edhe Feronikeli ndaj Trepçës '89



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Kampionia në fuqi e Superligës, Drita e ka fituar derbin më të madh në futbollin e Kosovës kundër Gjilanit me rezultat 2-3. Kjo ndeshje ishte e jashtëzakonshme ku solli pesë gola, ku tre gola janë shënuar vetëm në pjesën e parë. Pas shtatë minutave lojë, Nikaç e kaloi Gjilani në epërsi 1-0. Në minutën e 26-të, Hamdi Namani realizoi për 1-1. Katër minuta pa përfunduar pjesa e parë e ndeshjes, Gjilani e riktheu epërsinë me golin e Nikaç. Rastet nuk munguan, por barazimi erdhi vetëm në minutën e 89-të, kur sulmuesi me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Astrit Fazliu e barazoi rezultatit në 2-2. Në minutën e fundit, Betim Haxhimusa e vulosi rezultatit final 2-3. Drita në këtë mënyrë këndellet pas barazimit në xhiron e kaluar ndaj Feronikelit, kurse Gjilani e pëson humbjen e dytë radhazi, pasi xhiron e kaluar është mposhtur nga Arbëria. Pas kësaj ndeshje, Drita është e dyta me 30 pikë të grumbulluara, kurse Gjilani është në pozitën e katërt me 23 pikë. Ndërsa në ndeshjen tjetër,

Feronikeli e mposhti Trepçën '89 me rezultat 2-0. Në minutën e 30-të, Simonovski realizoi nga penalltia për epërsinë e parë të vendasve. Në pjesën e parë të dy skuadrat patën edhe nga një rast shënimi, por rezultati nuk ndryshoi. Në fillim të pjesës së dytë, Maliqi realizoi golin e dytë për "Niklin". Mysafirët patën rastet e veta, por nuk i shfrytëzuan dhe ndeshja përfundoi me rezultat 2-0. Feronikeli renditet në pozitën e pestë me 19 pikë, kurse Trepça '89 është e teta me 17 pikë. Të shtunën fitore i është gëzuar edhe Prishtina në përballje me Besën e Pejës (0-2). Në minutën e 31-të, Endrit Krasniqi e shfrytëzoi një pasim nga Mankenda dhe realizoi për 0-1. Në pjesën e dytë, Leotrim Kryeziu pas një topi të rikthyer shënoi për 0-2.

Ballkani pret tri pikë ndaj Arbërisë, sot takohen edhe Drenica - Llapi

Dy ndeshjet e fundit të javës së 15-të në Superligë zhvillohen sot (e hënë). Në Suharekë, Ballkani që po e dominon elitën në këtë edicion synon fitoren e radhës në ndeshjen kundër Arbërisë. Kjo e fundit nuk

do të hyjë në këtë ndeshje e dorëzuar, sidomos pas fitores së fundit kundër Gjilanit. Në ndeshjen tjetër në Skenderaj, Drenica e pret Llapi. Kuqezinjtë i kanë humbur dy ndeshjet e fundit dhe synojnë rezultat pozitiv, sikurse kërkon edhe Llapi që është në krizë të thellë rezultatesh në këtë edicion.

SUPERLIGA

Gjilani - Drita	2-1
Feronikeli - Trepça '89	2-0
Besa - Prishtina	0-2

Të hënën takohen:
Ballkani - Arbëria
Drenica - Llapi

Tabela

1. Ballkani	13	32 pikë
2. Drita	13	30
3. Prishtina	14	24
4. Gjilani	14	23
5. Feronikeli	15	19
6. Drenica	14	18
7. Arbëria	14	17
8. Trepça '89	15	17
9. Llapi	13	8
10. Besa	15	6

Në xhiron e radhës takohen: Prishtina-Feronikeli, Trepça '89-Gjilani, Arbëria-Drenica, Llapi-Besa, Drita-Ballkani.

SHKURT

Manaj, vendimtar në fitoren e Keciorengucut

Futbollisti nga Klina, Arb Manaj, ka shënuar edhe një tjetër gol në Turqi. Në ndeshjen mes të Keciorengucut dhe Adana Demirsportit, 22-vjeçari ka gjetur rrugën drejt golit në minutën e 26-të të takimit, duke i dhënë epërsinë fillestare skuadrës së tij, 1-0. Goli i Manajt doli të jetë vendimtar për fitoren e skuadrës së Keciorengucut. Ishte ky goli i pestë për Manajn këtë edicion në Ligën e Parë të Turqisë, që prej transferimit të tij këtë verë nga Trepça '89.

Broja shënon, Vitesse fiton

Sulmuesi i Shqipërisë, Armando Broja, ka realizuar gol në fitoren e Vitesse (2-0) ndaj Fortuna Sittardit, në xhiron e dhjetë të elitës së futbollit të Holandës. Broja e realizoi golin e dytë në minutën e 83-të, ndërsa luajti 86 minuta. Broja i ka realizuar pesë gola në dhjetë ndeshje në Eredivisie.

Mavraj i plotë në fitoren e Greuther Furthit

Mbrojtësi shqiptar, Mërgim Mavraj ka luajtur për 90 minuta në fushë në fitoren e skuadrës së tij në Bundesliga 2. Greuther Furth i Mavrajt ka shënuar fitore 2:3 në udhëtim te Nurnbergu në takimin e javës së nëntë. Mërgim Mavraj me skuadrën e tij janë në rrugë të mirë për inkuadrim në elitën e futbollit gjerman, pasi që ndodhen në vendin e parë me 18 pikë, një më shumë se vendi i dytë.

Hadërgjonaj asiston në fitoren e Kasimpasas

Futbollisti i Kosovës, Florent Hadërgjonaj ka asistuar për herë të parë në Superligën e Turqisë. Kasimpasa fitoi 2:0 kundër Gençlerbirliğit në kuadër të xhiros së 10-të në elitën e futbollit turk. Hadërgjonaj që luajti në gjithë ndeshjen, në minutën e 17-të të duelit, dha një top për Armin Hoxhiqin që nuk gaboi duke realizuar e parë në ndeshje. Hoxhiq e shënoi edhe golin e dytë dhe të rezultatit final në minutën e 25-të.

Vashat e Prishtinës mposhtin kampionet e Ferizajt

Kurteshi ka shënuar 11 gola për të udhëhequr Prishtinën drejt fitores ndaj kampionit aktual, Ferizajt. Ndeshja e luajtur në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj, përfundoi me rezultat 35:27 në të mirë të Prishtinës. Te kjo skuadër pos Kurteshit me efikasitet u dallua edhe Nivokazi me 8 gola. Te Ferizaj më efikasja ishte Domaneku me 8 gola. Prishtina ka fituar shtatë ndeshjet e deritashme dhe i ka 14 pikë, sa edhe Istogu e Vushtrria. Istogu po ashtu ka shtatë fitore në po aq ndeshje të luajtura, kurse Vushtrria ka shtatë fitore e një disfatë. Ferizaj renditet i pesti me 10 pikë.

Barazim mes legendave në boks

LOS ANGELES, 29 NËNTOR - Është mbyllur në barazim ndeshja e shumëpritur e boksit që pa rikthimin në ring të legjendës Mike Tyson. Në moshën 54-vjeçare "Iron Mike" sfidoi në

ndeshjen e ekzibicionit një tjetër emër të madh në historinë e boksit si 51-vjeçar Roy Jones Jr. Pavarësisht moshës së dy sportistëve të tërhequr prej kohësh, nuk munguan goditjet e

klasit. Edhe Mike Tyson, që u ngjiti në ring me doreza të zeza në nder të dy miqve të tij që u ndanë nga jeta gjatë këtij viti Kobe Bryant dhe Diego Armando Maradona, rishfaqti

disa prej karakteristikave që e bënin të pamposhtur gjatë rinisë së tij. Por në fund, gjyqtarët vendosën që sfida e zhvilluar në "Staples Center" të Los Angeles të mbyllet në barazim me pikë.



Kosova mposhtet edhe nga Islanda

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ka pësuar humbje nga Islanda me rezultat 86:62 (21:17, 24:12, 22:14, 19:19), në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Mungesa e disa basketbollistëve u vërejt edhe kësaj radhe te "dardanët", ashtu si edhe në përballje me Sllovakinë. Kosova e nisi ndeshjen më mirë me një epërsi prej 0:4, dhe ishte në epërsi konstante, ku më e larta ishte 11:17, megjithatë, ishullorët me një seri prej 10:0, e përfundojnë çerekun e parë 21:17. Në periodën e dytë, Islanda ishte më e mirë 24:12 dhe shkuan në pushim me rezultat 45:29. "Ishullorët" ishin më të mirë edhe në periudhën e tretë 22:14, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 67:43. 10 minutat e fundit ishin



tërësisht të barabartë, 19:19 dhe Islanda shënoi fitore me shifrat 86:62. Hordur Vilhjalmsson ishte shënuesi më i mirë te Islanda me 22 pikë, kurse te Kosova, Valon

Bunjaku me 12. Kosova ndeshjet e fundit në grup do t'i ketë në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, ku do të përballlet me Sllovakinë dhe Luksemburgun.

Marku: Do fitoj titullin për shqiptarët

TIRANË, 29 NËNTOR - Florian Marku e ka nisur mjaft mirë karrierën e tij në boks, pasi njeh vetëm fitore në 7 ndeshjet e tij të para në boksion profesionist. Ai ka bërë mjaft mirë deri tani, ndërsa kishte nevojë dhe për një shtyrje tjetër drejt majave. "Luani shqiptar" ka firmosur për kompaninë më të madhe në botë të menaxhimit në boks. Ai është pjesë e familjes Matchroom që drejtohet nga Eddie Hearn. Ky i fundit është menaxheri i Anthony Joshua dhe shumë boksierëve të tjerë elitare. Marku e ka njoftuar dhe vetë një moment të tillë dhe ka treguar synimet e tij të tanishme në boks. Ai mendon se nënshkrimi me një gurë si Hearn do të jetë hapi i duhur në karrierën e tij si boksier. "Çdo



gjë kam dashur ka qenë t'i tregoj botës se çfarë mund të bëj brenda ringut të boksit dhe të fitoj titullin e botës për të gjithë fansat shqiptarë në të gjithë botën dhe për Shqipërinë. Ndihej krenar që kam nënshkruar me

Matchroom dhe Eddie Hearn për të plotësuar hapat që duhen për fazën tjetër. Me suportin e fansave të mi, Matchroomboxing, Eddie Hearn dhe Sjamboxing çdo është e mundur", ka thënë Marku.

Zidane: Humbje e pashpjegueshme

Real Madrid pësoi një tjetër humbje në kampionat kundër Alaves, e cila është e tretë në këtë kampionat. Trajneri Zinedine Zidane ka fajësuar veten për humbjen, teksa ka

kërkuar reagim të menjëhershëm nga ekipi. "Kanë shënuar pas tri minutash, gjithçka është komplikuar menjëherë. Kur ndeshja fillon në këtë mënyrë, është e

vështirë. Nuk kemi luajtur si skuadër, duhet të ruajmë gjithmonë përqendrimin sepse çdo kundërshtar është i rrezikshëm. Nuk duhet të kërkojmë justifikime", ka thënë

Zidane. "Kemi bërë një ndeshje të keqe, veçanërisht në fillim dhe nuk kemi arritur të ndryshojmë. Në pjesën e dytë nuk kemi krijuar shumë raste dhe goli i dytë ka ardhur

menjëherë. Gabimet e lojtarëve? Është faji im, jam trajneri. Duhet të ndërrojmë faqe, të martën kemi një ndeshje tjetër", ka deklaruar Zidane.

SHKURT

Berisha rezulton pozitiv me Covid

Koronavirusi nuk u ndahet futbollistëve të kombëtares shqiptare. Së fundmi pozitiv me COVID-19, ka rezultuar kapiteni i kuqezinjve portieri Etrit Berisha. Lajmin e bën të ditur klubi i tij, SPAL, që tregon gjithashtu se Berisha nuk ka pasur kontakte me pjesën tjetër të skuadrës që pas grumbullimit me kombëtaren. Berisha ka qenë i karantinuar gjatë këtyre ditëve në shtëpinë e tij, sipas rregullave të autoriteteve mjekësore në Ferrara. Në tamponin e kryer së fundmi, që duhej të ndodhte para bashkimit me skuadrën, Berisha ka rezultuar i infektuar. Lajm i keq për gardianin e kombëtares sonë, që gjatë javëve të fundit ishte në superformë dhe ndihmonte SPAL vazhdimisht për të arritur rezultate pozitive. Ajo që druhejshin më shumë te Spal tashmë ka ndodhur dhe skuadrës nga Ferrara nuk i mbetet gjë tjetër veçse të gjejë një zgjidhje dhe të luajë në disa takime pa portierin e saj titullar.

Alaba, afër marrëveshjes me Chelsea

Menaxheri i David Alabas, Pini Zahavi ka nisur kontaktet e para me Chelsea dhe shumë shpejt mund të takohet me drejtuesit e londinezëve për të negociuar kontratën që do ta lidhte me të kaltrit e Londrës. Sipas gazetës gjermane "Bild", Alaba me gjasë do t'i bashkohet Chelseat. Mbrojtësi anësor dhe Bayerni e kishin një verë të gjatë pa arritur të gjenin gjuhë të përbashkët për vazhdimin e marrëveshjes. Duket se mospajtimet që kanë çuar drejt dështimit të marrëveshjes ishin kërkesat e larta për pagë të austriakut.

Donnarumma: Dua të qëndrojë të Milani për një kohë të gjatë

Portieri i AC Milanit, Gianluigi Donnarumma ka konfirmuar se dëshiron t'i mbetet besnik skuadrës. "Gardiani" i "Rossonerëve" ishte i lidhur me largimin nga "San Siro" në afatin veror, transmeton lajmi.net. Italiani ende s'ka rinovuar kontratën me klubin italian, por ka konfirmuar se nuk ka ndonjë problem. "Agjenti do flas me klubin, nuk ka probleme. Dua të qëndrojë të Milani për një kohë të gjatë. Por, do shohim çfarë do vendos klubin. Dua të kënaqem në këtë momente sa më gjatë që të mundem", ka thënë Donnarumma. Kontrata momentale Donnarummas i skadon në qershor të vitit 2021.

Fernandinho konfirmon largimin nga City

Mesfushori Fernandinho ka vendosur të largohet nga Manchester City në fund të sezonit, kur edhe i përfundon edhe kontrata me "citizens". Megjithatë 36-vjeçari nuk ka ndërmend të tërhiqet nga futbollit ende, pasi ka deklaruar se po merr në konsideratë ofertat nga klubet braziliane dhe ato të MLS-së amerikane, ku mund të vijojë të luajë edhe për një apo dy vite të tjera. City kishte paguar rreth 40 milionë euro për kartonin e mesfushorit brazilian në verën e 2013-ës, ndërsa që atëherë Fernandinho ka luajtur 320 ndeshje me fanellën e "sky blues" dhe ka shënuar 23 gola.

LULËZIM ETEMAJ

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpijt e gjakut“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatërresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumëfishta nxjerr përpara lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpërinjtë e vërtetë, si parakusht për një mobilizim të përgjithshëm për çlirimin kombëtar.

Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhështi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhësinë kombëtare, është autori i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unitetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoi, në të vërtetë, parakushtet për luftën triumfuese çlirimtare, falë këtij boshti qytetërues dhe drejtimit të saktë gjeopolitik.

Muhamet Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË
(1990-1991)




“A po shkruan Barney?”
 “Ta merr mendja. Shkruaj gjithë kohën e lume”.
 “A nuk ta ndërpresin punën adhuruesit?”
 “Jo, ore, ngandonjëherë femrat më gjejnë, ama ato nuk qëndrojnë gjatë”.
 “A po të shiten librat?”
 “Po marrë çeqe nga të drejtat e autorit”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e rinj?”
 “Pini, qini dhe pini shumë cigare”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e vjetër?”
 “Në qoftë se ende jeni gjallë, nuk keni nevojë për kurrfarë këshille”.
 “Çka ju shtyn të shkruani poezi?”
 “Çka ju shtyn juve të dhjesni?”
 “Çka mendoni për Reaganin dhe papunësinë?”
 “S’e çaj kokën as për Reaganin e as për papunësinë. E gjithë kjo më mërzi. Sikur fluturimet në gjithësi dhe Super Bowl”.
 “Atëherë për çfarë merakoseni?”
 “Për femrat moderne”.
 “Për femrat moderne?!”
 “Po, se ato nuk dinë si të vishen. Këpucët i kanë tmerrësisht të këqija”.
 “Çfarë mendoni për emancipimin e gruas?”
 “Sapo të jenë të gatshme të merren me larjen e automobilave, t’i lëvrojnë arat, t’i ndjekin ata dy tipat që e plaçkiten dyqanin e pijeve, apo t’i pastrojnë kanalizimet e ujërave të zeza, kurdo që të jenë të gatshme që bombat në ushtri t’ua hedhin armiqve si sisët në ajër, unë jam i gatshëm të rri në shtëpi dhe t’i laj enët dhe të mërziem duke i mbledhur fijet nga qilimi”.

(Fragment nga tregimi “Emancipimi i gruas”)

4.99 €




Charles Bukowski • Emancipimi i gruas



CHARLES BUKOWSKI
EMANCIPIMI I GRUAS

Përktheu: Fadil Bajraj





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► D.P.Z. "Gedore" me seli në Prishtinë, me numër të biznesit: 71157342, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 601251549

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

